



Përgjigje ndaj Raportit Konsultative të ZRRE-së mbi cakun e reduktimit të humbjeve_2017

Hyrje

Në sistemet energjetike me humbje u referohemi dallimeve të energjisë elektrike të futur në sistem dhe energjisë së shpërndarë tek konsumatorët fundor, respektivisht është sasia e energjisë elektrike e injektuar në rrjet e cila nuk paguhet nga konsumatorët. Humbjet totale përbehen nga dy komponentë, humbjet teknike dhe humbjet jo-teknike (humbjet komerciale). Humbjet teknike ndodhin natyrshëm gjatë kalimit të energjisë elektrike nëpër elementet e sistemit siç janë linjat e shpërndarjes, transformatorët dhe sistemet matëse. Humbjet komerciale shkaktohen nga veprimet jashtë sistemit energjetik dhe përbëhen kryesisht nga vjedhjet e energjisë elektrike dhe gabimet gjatë regjistrimit të të dhënave. Këto kategori të humbjeve cilëson ndryshe edhe si humbje komerciale.

Optimizmi i humbjeve teknike në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike

është problem inxhinierie që përfshin metodat klasike të planifikimit dhe modelimit të sistemit. Qëllimi dhe kriteri bazë i planifikim dhe modelimit të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes

së energjisë elektrike është minimizimi vlerës neto aktuale i kostove të investimeve plus kostove

të humbjeve teknike. Humbjet teknike përfaqësojnë gjithashtu një humbje ekonomike për vendin, prandaj optimizmi i tyre duhet parë nga perspektiva shtetërore pavarësisht organizimit institucional të sektorit dhe pronësisë të operatoreve të energjisë elektrike¹.

Humbjet komerciale përfaqësojnë një humbje të shmangshme financiare për operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike në qoftë se legjislacioni dhe institucionet përkatëse mbështesin kompaninë për luftimin dhe eliminimin e humbjeve komerciale. Me gjithë faktin se sasia e energjisë elektrike e përfshirë në humbjet komerciale konsumohet nga përdorues që nuk e paguajnë atë, eksperiencia tregon që një përqindje e konsiderueshme e kësaj energjie elektrike zvogëlohet kur nga përdoruesit kërkohet të paguajnë për këtë energji elektrike. Ky zvogëlim i kërkesës ka saktësisht efektin e njëjtë sikurse edhe zvogëlimi i humbjeve teknike,

¹ Grupi i Bankës Botërore, Strategjia e Sektorit të Energjisë, Reduktimi i Humbjeve teknike dhe jo-teknike në sektorin e energjisë elektrike, 2009



respektivisht nevojë më e vogël për blerje të energjisë elektrike. Andaj nga perspektiva e vendit edhe zvogëlimi apo eliminimi i humbjeve jo-teknike (komerciale) ka ndikim shumë pozitiv².

Nga pikëpamja sociale humbjet komerciale kanë një efekt shume negativ, sepse konsumatorët e rregullt subvencionojnë edhe përdoruesit që nuk paguajnë për energjinë elektrike të cilën e konsumojnë. Ekzistojnë një varg rrethanash që mund të shkaktojnë humbje komerciale. Rastet klasike janë vjedhjet e energjisë elektrike nga lidhjet e paautorizuara dhe manipulimet e pajisjeve matëse. Është e qartë që këto veprime përbejnë vepra penale që ndiqen në bazë të ligjeve në fuqi, por në rastet kur operatorët nuk kanë mbështetje të mjaftueshme të kornizës rregullative dhe sistemi i drejtësisë vepron shume ngadalë, operatorët e kanë shumë të vështirë për të eliminuar efektin e keq social dhe ekonomik që shkaktojnë humbjet komerciale³.

Zvogëlimi i humbjeve teknike është rezultat i investimeve të mëdha kapitale dhe mirëmbajtjes adekuate të sistemit të shpërndarjes. Investimet kapitale kërkojnë analizë dhe diagnozë të thellë të sistemit, identifikim të gjendjes aktuale, përcaktimin e zonave më problematike, analizën e kostos dhe përfitimit etj. Në sistemet e shpërndarjes të shumë vjetërsuara, në të cilat nuk janë bërë investimet e duhura kapitale dhe nuk janë mirëmbajtur sistematikisht për vite të tëra, është e vështirë të merren rezultatet e kënaqshme në lidhje me zvogëlimin e humbjeve teknike në një periudhë të shkurtër kohore.

Humbjet përgjatë viteve

Rrjeti i shpërndarjes u privatizua në vitin 2013 dhe KEDS ka trashëguar një rrjet shumë të dëmtuar dhe të vjetër, për shkak të mungesës së investimeve para luftës (1999), si dhe neglizhimin e investimeve në dekadën e parë të vitit 2000. Kur KEDS privatizoi shërbimet e shpërndarjes, parametrat e periudhës së parë rregullatorë ishin vendosur tashmë.

Bazuar në raportin për konsultim publik të lëshuar nga ZRRE lidhur me objektivin e humbjes së shpërndarjes, i lëshuar në vitin 2011, humbjet teknike gjatë periudhës 2006-2010 kanë mbetur mjaft statike, në rreth 16% në 17%, duke treguar se ndonëse ka pasur investime në rrjet për të rritur kapacitetin dhe për të kyçur konsumatorët e rinj, ndikimi i tyre në zvogëlimin e humbjeve teknike ka qenë shumë i vogël. Humbjet komerciale, nga ana tjetër, ishin shumë të larta në krahasim me standardet ndërkombëtare; Vendet me praktika më të mira për matje, faturim dhe arkëtim kanë nivel humbjesh komerciale nën 10%. Fokusi kryesor i Rregullatorit në atë kohë ishte zvogëlimi i humbjeve komerciale, dhe edhe pse në afatgjatë dëshira e Rregullatorit ishte të ulnin humbjet e shpërndarjes në Kosovë në rreth 15%, ose një ulje prej 25% (pikësh) nga nivelet aktuale. Raporti thekson se reduktime të tilla do të kërkojnë kohë të

² Grupi i Bankës Botërore, Strategjia e Sektorit të Energjisë, Reduktimi i Humbjeve teknike dhe jo-teknike në sektorin e energjisë elektrike, 2009

³ Grupi i Bankës Botërore, Strategjia e Sektorit të Energjisë, Reduktimi i Humbjeve teknike dhe jo-teknike në sektorin e energjisë elektrike, 2009



konsiderueshme për t'u arritur, ashtu edhe siç ilustron nga vetë raporti i ZRRE-së, respektivisht nga mungesa e dukshme e ndikimit të investimeve të bëra në rrjet në zvogëlimin e nivelit të humbjeve.

Me vendimin nr. V_399_2012, ZRRE vendosi që gjatë periudhës së parë rregullative të aplikohet lakorja e reduktimit të humbjeve, bazuar në vlerën e humbjeve të regjistruara në rrjetin e shpërndarjes në vitin 2011. Sipas këtij vendimi, humbjet në periudhën kalimtare njëvjeçare (periudhe transitore) dhe në çdo vit të periudhës rregullatore duhet të zvogëlohet me një numër të caktuar pikë-përqindjeje, krahasuar me humbjet e vitit të kaluar, respektivisht: 3 pikë përqindjeje në vitin tranzitor, 3 pikë përqindjeje në secilin prej dy viteve të para të periudhës rregullatore dhe 2.5 pikë përqindjeje në secilin nga tre vitet e ardhshme të periudhës së parë rregullatore.

Është e rëndësishme të theksohet se KEK-u në vitin 2012 (i cili ishte mbajtës i licencës për shërbimet e shpërndarjes) ka arritur nivelin aktual të humbjeve të shpërndarjes në 32.3% nga energjia e futur në sistemin e shpërndarjes ose një nën-performancë prej 1.9%, krahasuar me cakun prej 3% sipas vendimit të ZRRE-së Nr. V_399_2012. Kjo tregon se caqet indikative të përcaktuara nga ZRRE për reduktimin e humbjeve në vitin 2012 nuk janë përmbushur gjatë kohës kur shpërndarja dhe furnizimi ishin nën menaxhimin e KEK-ut si kompani publike dhe e integruar si një kompani e vetme. Duke ditur faktin se KEDS filloi veprimtarinë e saj më 8 maj 2013, kjo nënkuptonte se KEDS duhej të ulte humbjet me 5% deri në fund të dhjetorit 2013.

Një zvogëlim i humbjeve prej 5% nuk ishte parashikuar gjatë kohës së bisedimeve për përmbajtjen e transaksionit të privatizimit, prandaj në këtë kuptim, KEDS më 4 qershor 2013 ka dërguar një shkresë zyrtare në ZRRE për shqyrtimin e parametrave rregullator që ka të bëjë me objektivat indikative për reduktimin e humbjeve, duke kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të ri-llogarisë pikën e fillimit të humbjeve të lejuara bazuar në nivelin e humbjeve të arritura në vitin 2012 dhe ulja e tyre me 3% (pikë përqindje) në vitin 2013, gjë që do të siguronte që KEDS si mbajtës i ri i licencës nuk do të penalizohej për nën-performancën e KEK-ut. E njëjta shkresë iu dërgua edhe të gjithë vendimmarrësve dhe përfaqësuesve të njësisë së privatizimit nën Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, megjithatë KEDS nuk mori asnjë përgjigje nga asnjë palë adresuese.

Më poshtë kemi krahasuar humbjet aktuale të arritura nga Operatori i Shpërndarjes kundrejt nivelit të lejuar të humbjeve në bazë të Vendimit V_399_2012 dhe nivelit aktual të humbjeve dhe humbjeve të ri-kalkuluara për vitin 2012. Duhet të theksohet se 1,9% e humbjeve të trashëguara nga viti 2012 ka efekt të përbërë në humbje, e cila në baza vjetore paraqet një diferencë prej 11.4% (përqindje)

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Caku i humbjeve	-3.00%	-3.00%	-3.00%	-2.50%	-2.50%	-2.50%



	2012	2013	2014	2015	2016	2017*	Totali i përbërë
Humbjet totale te realizuara	32.30%	31.03%	28.46%	26.55%	24.45%	22.90%	
Zvogëlimi		-1.27%	-2.57%	-1.91%	-2.10%	-1.55%	
Humbjet e lejuara nga ZRRE	30.40%	27.40%	24.40%	21.90%	19.40%	16.90%	
Dallimi i humbjeve-aktuale dhe te lejuara	1.90%	3.63%	4.06%	4.65%	5.05%	6.00%	25.29%
Humbjet e ri-kalkuluar ne vitin 2012	32.30%	29.30%	26.30%	23.80%	21.30%	18.80%	13.89%
Dallimi i ri	0.00%	1.73%	2.16%	2.75%	3.15%	4.10%	
Diferenca e totaleve te përbëra							11.40%

*E pritshme

KEDS do të jetë i përkushtuar të zvogëloj humbjet sa më shumë që është e mundur. Në këtë kuptim, KEDS gjatë vitit të parë rregullativ ka investuar mbi 100 milion €, e cila ka rezultuar me një zvogëlim të humbjeve teknike prej 3.26% (pikë përqindjeje). Kjo tregon një trend pozitiv të investimeve dhe punë të madhe e njëherazi edhe gatishmërinë e kompanisë për t'i zvogëluar humbjet teknike, krahasuar me të dhënat e dhënë në raportin konsultativ për periudhën e parë rregullative për reduktimin e humbjeve aktuale gjatë periudhës 2006-2010, kur donatorët po ofronin donacione të shumta për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes. Është shumë e rëndësishme të theksohet që kostot për zvogëlimin e humbjeve teknike janë shumë të larta. Shuma e humbjeve teknike mund të ndikohet nga operatorët e rrjetit të paktën në afat të mesëm dhe nga investimet e duhura në rrjete⁴. KEDS gjatë kësaj periudhe ka treguar një trend pozitiv përmirësimi dhe është i gatshëm të vazhdojë nëse kostot marginale për reduktimin e humbjeve përputhen me kostot marginale të humbjeve në rrjet.

Nga ana tjetër, studimet dhe praktikat tregojnë se reduktimi i humbjeve komerciale është më pak i kushtueshëm dhe shumë më i lehtë dhe më i shpejtë krahasuar me reduktimin e humbjeve teknike. Duke ditur këtë, KEDS ka vënë shumë përpjekje dhe përkushtim në këtë drejtim dhe si rezultat ka krijuar gjithashtu edhe një Departament të veçantë për uljen e humbjeve. Megjithatë, ulja e humbjeve kërkon gjithashtu mbështetjen e institucioneve të zbatimit të ligjit, gjegjësisht kjo mund të arrihet duke zbatuar matjet strikte të shqyçjes, duke shkëputur përgjithmonë të gjithë konsumatorët që keqpërdorin energjinë elektrike dhe kryejnë veprime të tjera të paligjshme. Gjatë periudhës së parë rregulluese, KEDS ka reduktuar humbjet komerciale nga 15.9% në vitin 2012 në 11.41% në vitin 2016, një reduktim total prej 4.5% (pikë përqindjeje). Por Kosova është shumë e dobët në zbatimin e Ligjit, e cila paraqet një nga mbështetjet më të rëndësishme të operatorëve të shpërndarjes drejt uljes së humbjeve komerciale. Të gjitha raportet kombëtare dhe ndërkombëtare, theksojnë se pengesat dhe sfidat

⁴ Grupi Rregullator Evropian për Energji Elektrike dhe Gaz (2008), Trajtimi i Humbjeve nga Operatorët e Rrjetit, Dokumenti i Qëndrimit të ERGEG për Konsultim Publik, Ref: E08-EN-04-03, 2008



kryesore për Kosovën mbeten sundimi i dobët i ligjit dhe korrupsioni⁵. Nëse marrim në konsideratë edhe nën-zhvillimin ekonomik të vendit, papunësinë dhe varfërinë e lartë, është mjaft normale që humbjet komerciale të mbeten të larta dhe megjithatë edhe në këto kushte KEDS ka arritur të ulë humbjet komerciale në një nivel të arsyeshëm krahasuar me ato para procesit të privatizimit.

Tani në procesin e liberalizimit të tregut, ndryshimet legislative, të cilat mbështesin edhe më shumë konsumatorët, të propozohet një reduktim i humbjeve në nivel prej 13.2% deri në vitin 2022, apo një reduktim i prishëm prej 12.5% (pikë përqindjeje) krahasuar me humbjet aktuale të reduktuara deri në vitin 2016 është shumë optimiste dhe joreale.

Propozimi i KEDS-it

Në mënyrë që të mbahen humbjet në një nivel të ulët dhe të arsyeshëm, rregullatorët krijojnë mekanizma nxitës që japin shpërblime (ose dënime) për operatorët e rrjetit kurdo që humbjet janë nën (ose më lart) një nivel objektiv të paracaktuar. Këto mekanizma janë të arsyetuara nga fakti se operatorët e rrjetit kanë deri në një mase aftësinë për të kontrolluar humbjet, pasi që ata janë përgjegjës për disa aktivitete të tilla si projektimi i rrjetit, mirëmbajtja dhe vendimet e investimeve në lidhje me instalimin e pajisjeve të rrjetit, që luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e humbjeve. Prandaj, është e rëndësishme të sigurohet që operatorët e rrjetit të kanë stimuj adekuat në mënyrë që ata të bëjnë një përpjekje të duhur për të vlerësuar kostot dhe përfitimet e reduktimit të humbjeve dhe kështu të optimizojnë nivelin e humbjeve në mënyrën më efektive⁶.

Ne këtë kuptim dhe duke marr parasysh të gjitha argumentet e lartpërmendura, KEDS propozon skenarin, si në vazhdim, i cili vlerësohet si i arsyeshëm, i arritshëm dhe shumë real, i cili për më tepër siguron ofrimin e shërbimeve kualitative për konsumatorin fundor dhe siguron edhe qëndrueshmërinë e kompanisë.

Propozimi:

Ri-vendosja e caktimit, duke marr në konsideratë humbjet aktuale të arritura në vitin 2017, respektivisht duke marr parasysh humbjet aktuale të arritura në vitin 2016 dhe korrigjimin e dallimit ndërmjet vlerave të vlerësuara dhe aty të realizuara për vitin 2017, kurdo që ato janë të qasshme, si dhe caktimi i caktimit prej 1% të reduktimit të humbjeve për çdo vjet, ashtu siç është paraqitur në tabelën në vijim:

⁵ Komisioni Evropian, Raporti i progresit për Kosovën, 2016, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf

⁶ Grupi Rregullator Evropian për Energji Elektrike dhe Gaz (2008), Trajtimi i Humbjeve nga Operatorët e Rrjetit, Dokumenti i Qëndrimit të ERGEG për Konsultim Publik, Ref: E08-EN-04-03, 2008



2016 Aktuale	2017 Te pritshme
24.45%	22.90%

	2018	2019	2020	2021	2022
Caku i humbjeve	-1.0%	-1.0%	-1.0%	-1.0%	-1.0%
	21.90%	20.90%	19.90%	18.90%	17.90%

Diferenca	5.0%
-----------	-------------

Deri në vitin 2022, humbjet totale do të arrinin në 17.9%, një dallim prej 5% (pike përqindjeje) më e vogël se ato aktuale. Ky propozim do të ndihmonte OSSH-në edhe rreth efektit të përbërë me të cilën OSSH është përballur gjatë tërë këtyre viteve, për shkak të mos-performancës së duhur nga mbajtësi paraprak i licencës dhe neglizhimit të institucioneve për të rivendosur cakun e humbjeve sipas nivelit aktual të arrirë në vitin 2012. Për me tepër, ky propozim është i ngjashëm me rezultatet e arritura nga Maqedonia gjatë periudhës së njëjtë dhe me piken e njëjtë fillestare.

Propozimi i rregullatorit për të mos i ri-vendosur caqet, por ti mbajë ato në të njëjtin cak siç ishte në fund të periudhës aktuale tarifore është e papranueshme, meqenëse si e tillë do të vazhdoj të rëndoj KEDS me caqet agresive të vlerësuara gjatë vitit 2012 dhe madje edhe më të larta marr parasysh humbjet e trashëguara nga KEK për vitin 2012. Përderisa qasja e propozuar nga KEDS, do të sigurojë stabilitet financiar për operatorin e shpërndarjes, e cila tutje do të lejoj operatorin të fokusohet në zbatimin e investimeve dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimit.

Në një doracak të përgatitur nga PA Grupi Konsulentë për USAID në nëntor të vitit 2004⁷, janë paraqitur kushtet kritike për arritjen e suksesit në reduktimin e qëndrueshëm të humbjeve në shpërndarjen e energjisë elektrike, të cilat janë nxjerre nga një rishikim gjithëpërfshirës i përvojave ndërkombëtare të vendeve në zhvillim. Ndër të tjera, një nga kushtet kritike është qasja holistike, e cila thotë se suksesi i reduktimit të humbjeve varet në pjesën e krijimit dhe motivimit të institucioneve për të përmbushur rolet e tyre në një ristrukturim të mjedisit sektorial. Përkatësisht, qasja e përdorur nga rregullatorët duhet të përfshijë aspektet teknike, procesin, kapacitetet njerëzore dhe gatishmërinë për të prodhuar rezultate. Duke synuar një aspekt pa marrë në konsideratë se si ky element ndër vepron ose ndikon në balancën e sektorit mund të çojë në rezultate joefektive, jo optimale apo edhe shkatërruese.

ZRRE-ja në propozimin e saj të paraqitur në Raportin Konsultative për caktun e reduktimit të humbjeve për periudhën e dytë rregullative, po rrit presionin financiar për KEDS-in dhe nuk po shqyrton shumë çështje dhe fakte të rëndësishme, siç janë deklaratat e veta të dhëna në dokumentin e tij të konsultimit për periudhën e parë rregullatore lidhur me vështirësitë për zvogëlimin e humbjeve teknike; si dhe po përjashton faktet se konsumi i energjisë elektrike në

⁷ USAID, 2009, Përmirësimi i operimeve të kompanive për shpërndarjen e energjisë elektrike për të përsheptuar reformën në sektorin e energjisë elektrike.



Ndërtesa e Elektrokosovës *Elektrokosova Building*
Bulevardi Bill Klinton nr.3 *Bill Clinton Boulevard no.3*
Prishtinë 10000 *Prishtina 10 000*
Republika e Kosovës *Republic of Kosovo*



Kosovë kryesisht konsiston në konsumin familjar (mbi 60%); se ekonomia është e pazhvilluar; papunësia është shumë e lartë; dhe se sundimi i ligjit në vend është shumë i dobët.

Andaj KEDS, me mirësjellje kërkon nga ZRRE të shqyrtoj edhe një herë propozimin e saj dhe ndikimin që ky vendim mund të ketë në operimet e OSSH-së gjatë 5 viteve në vijim.